



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

Duke u mbështetur në Nenin 35.1 Ligjin e Prokurimit Publik 04/L-042 Neni 35.1 i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237 i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 05/L-068 dhe 05/L-092 si dhe uke u bazuar në punimet e suksesshme, nga ana e kontraktorit dhe duke qenë se, për implementimin e plotë të projektit “NDËRTIMI I SHTËPISË SË KULTURËS NË BANJË – PUNË E PA PARAPARË” janë të nevojshme punë shtesë, bazuar edhe në APROVIMIN nga Autoriteti Kontraktues për përdorimin e Procedurave të Prokurimit datë 25.06.2018 në Istog është pajtuar të lidhin këtë:

ANEX KONTRATË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson zj. Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga “Fadil Ferati” nr. 121 në njërën anë; dhe

NPN “ALPING” të cilën e përfaqëson, z. Basret Selimi, nga Prishtina, Komuna e Prishtinës, me Nr. Rexh. Biznesi, 70533030 (në vazhdim “Kontraktuesi”), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I ANEX KONTRATËS:

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit “NDËRTIMI I SHTËPISË SË KULTURËS NË BANJË – PUNË E PA PARAPARË”

Nr. I prokurimit	633-18-034-535
------------------	----------------

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve sipas kësajë kontrate është: 9.371,56 € dhe me fjalë /Nëntë mijë e treçind e shtatë dhjetë euro/56/100

Neni 3

Komunikimet



3.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

3.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

3.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

Për Autoritetin Kontraktues:

Për Kontraktorin:

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Basret Selimi
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës I Prokurimit	Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	23.07.2018	Data:	23.07.2018
Vula:		Vula:	